



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr. 19, datë 23.04.2020

MBI

MIRATIMIN PËR PRISHJEN E DETYRUAR TRE NDËRTESAVE, PJESË PËRBËRËSE TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE “NJAZI MASTORI”, QË MBAJNË NR. 6, 12 DHE 17 , TË LISTËS, QË ME VKM NR. 297, DATË 28.4.2010, KANË KALUAR NË PRONËSI TË BASHKISË SUKTH (SOT BASHKIA DURRËS), PËR SHKAK SE JANË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E DATËS 26 NËNTOR 2019 DHE RIPARIMI MUND TË JETË SHUMË I KUSHTUESHËM, SIPAS AKTEKSPERTIZËS SË THELLUAR, REALIZUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT DHE MIRATIMIN PËR HEQJEN NGA KONTABILITETI DHE LISTA PËRFUNDIMTARE TË TRE PRONAVE PJESË PËRBËRËSE TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE “NJAZI MASTORI”, QË MBAJNË NR. 6, 12 DHE 17, ME VENDODHJE NË QENDËR SUKTH, NJËSIA ADMINISTRATIVE SUKTH, QË ME VKM NR. 297, DATË 28.4.2010, KANË KALUAR NË PRONËSI TË BASHKISË SUKTH, (SOT BASHKIA DURRËS)

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM-së nr. 297, datë 28.04.2010 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Sukth, të Qarkut Durrës”, VKM-së nr.796, datë 11.12.2019 “Për një ndryshim në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, VKM-së nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “ Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, shkresës nr. 486, datë 19.02.2020, ardhur nga Instituti i Ndërtimit, me lëndë “Dërgim Akt ekspertizë”, ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,

i ndryshuar, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve dhe Drejtoria Ligjore në Bashkinë Durrës me propozim të Zëvendëskryetarit Bashkisë z.Zhuljen Varfaj, i cili kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

### V E N D O S I :

1. Miratimin për prishjen e detyruar të tre ndërtesave pjesë përbërëse të shkollës 9-vjeçare “Njazi Mastori”, që mbajnë nr. 6, 12 dhe 17 të listës, që me VKM nr. 297, datë 28.4.2010, kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Sukth (sot Bashkia Durrës), për shkak se janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 Nëntor 2019 dhe riparimi është shumë i kushtueshëm, sipas aktekspertizës së thelluar realizuar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë.
2. Miratimin për heqjen nga lista paraprake e pronave të Njesisë Administrative Sukth, Bashkia Durrës, të pronës me nr.6, 12 dhe 17, me vendodhje në qendër Sukth, Njësia Administrative Sukth, pjesë përbërëse të shkollës 9-vjeçare “Njazi Mastori”, që me VKM nr. 297, datë 28.4.2010, kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Sukth (sot Bashkia Durrës).
3. Drejtoria Ekonomike, Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe Njësia Administrative Sukth, që në zbatim të ligjit nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, të kryejnë veprimet në librat e inventarit ekonomik, përditësimin e listës së pronave të paluajtshme dhe fshirjen në regjistrat e pasurive të paluajtshme Durrës, të pronave me nr.6,12 dhe 17, me vendodhje në qendër Sukth, Njësia Administrative Sukth, pjesë përbërëse të shkollës 9-vjeçare “Njazi Mastori”, që me VKM nr.297, datë 28.04.2010, janë pjesë e listës paraprake të pronave që duhet të kalojnë në pronësi të ish-Bashkisë Sukth (sot Bashkia Durrës).
4. Toka (trualli) i liruar nga prishja e tre ndërtesave të përcaktuara në pikën 1 të këtij projektvendimi, nëse i plotëson kushtet për rindërtim (pasi të studiohet për kushtet gjeologjike dhe sizmike), të përdoren për rindërtimin e tre ndërtesave të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore.
5. Shpenzimet për shembjen e tre objekteve të përcaktuar në pikën 1 të mbulohen nga institucionet përkatëse, Inspektorati Mbrojtjes Territorit Vendor, Durrës.
6. Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve, që bazuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të bashkëpunojnë punën me Njësinë zbatuese (Fondin e Zhvillimit), që administrojnë fondet për rindërtim, që transferohen nga Këshilli i


Ministrave, prej fondit të rindërtimit, për të realizuar rindërtimin e e tre ndërtesave pjesë përbërëse e shkollës 9-vjeçare “Njazi Mastori”, të përcaktuara në pikën 1 të këtij projektvendimi, si dhe përfshirjen në listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të ndërtesave, pas realizimit të rindërtimit.

7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Drejtoria e Përgjithshme Ligjore.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 23.04.2020**